REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 1899 Prot

Maliq, më 30.03.2026

VENDIM
Nr. 40 datë 27.03.2026

"Për miratimin e rendit të ditës të mbledhjes së datës 27.03.2026 të Këshillit të Bashkisë Maliq"

Në zbatim të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"* i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma "b", neni 53 pika 3, neni 54 gërma "k" si dhe nenit 66, pika 11 e Rregullores të fuksionimit të Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, Këshilli i Bashkisë Maliq,

VENDOSI:

1.Të miratojë rendin e ditës për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Maliq, të datës 27.03.2026 me ndryshimet e propozuara dhe njoftimit bashkangjitur.

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar me 17 vota
Vota Pro 17
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 30.03.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.1634/1 Prot.

Maliq, më 18.03.2026

NJOFTIM

LËNDA: Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Maliq

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ
KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, *"Funksionimi i këshillit bashkiak"*, pika 2, pika 4 dhe 5, neni 56 *"Kryetari i këshillit bashkiak"* pika 2 gërma "a", dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, *"Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq"* ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të këshillit ditën e premte**, më datë 27.03.2026**, **ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të kaluara (10.02.2026, 27.02.2026)
4.P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin shkurt 2026";
5.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë"
6.P-V "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.2 datë, 08.01.2026 *"Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera për vitin 2026";* i ndryshuar.
7.P-V "Për "Miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 në nivel programi";
8.P-V "Për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor dhe krijimin, organizimin dhe funksionimin e shërbimit vullnetar të bashkisë Maliq";
9.P-V "Për miratimin e listës së kullotave dhe kositjeve për sezonin 2026 dhe miratimin e kontratës tip të dhënies me qira për kullotje'';
10.Diskutime të tjera.

Shënim: Mbledhjet e Komisioneve të Këshillit do të mbahen ditën e mërkurë me datë 25.03.2026 nga ora 10:00-13:00 si më poshtë:

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut. Pikat 4, 5 e rendit të ditës:
z.Faslli Zholli, znj.Gentiana Drabo, z.Armando Dautllari, z.Plator Çollaku, znj.Marjeta Xhelollari

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare. Pikat 6, 7 të rendit të ditës:
z.Petrit Kupe, znj.Pranvera Begolli, znj.Marianthi Avrami, znj.Eglantina Balli, z.Andonaq Risto.

Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të ujrave, Mbrojtjes së Mjedist dhe Biodiversitetit. Pikat 8,9 të rendit të ditës:
z.Lulëzim Hoxhaj, z.Fevri Sherifi, z.Selami Muço, znj.Rovena Terolli, znj.Albina Xhejo

Ju faleminderit!

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ